VENDIM

Nr. 804, datë 24.12.1998

PËR MBYLLJEN E PROCESIT TË KONTROLLIT DHE TË ADMINISTRIMIT PËR SHOQËRITË "AGRONI" SH.P.K. DHE "KAMBO MARSHALL" SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 11, të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procesit të kontrollit dhe të administrimit të shoqërive tregtare "Agroni", sh.p.k., dhe "Kambo Marshall", sh.p.k., të kryera nga ekspertët financiare vendas, të pavarur.

2. Grupi Mbikëqyrës dhe ekspertët financiarë vendas, dokumentacionin e grumbulluar gjatë periudhës së kontrollit dhe të administrimit të shoqërisë "Agroni", sh.p.k., dhe "Kambo Marshall", sh.p.k., t'ua kalojnë organit të prokurorisë, për fillimin e procedurave hetimore e gjyqësore ndaj ish-administratorëve të këtyre shoqërive.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko